ARGUMENT A

Autori bën një përshkrim të kujdesshëm të historive të Sahat Kullave të shekujve të shkuar dhe pastaj e hedh vështrimin në qytetin e Beratit. "Berati është vizituar nga mjaft piktorë të huaj duke u bërë edhe pjesë e krijimtarisë së tyre. Elementët real të peisazhit të Beratit, i gjejmë te ikona dhe afreske të pikturës bizantine e posbizantine, por dhe te udhëtimet e artistëve evropianë", shprehet ai. Më poshtë shton argumentin e tij për këto vepra...

KULLAT e SAHATIT në BERAT

HULUMTIMI: (Arsyeja kryesore mbi këto mendime, analiza dhe shënime në këtë shkrim, janë të dhënat e kronikanit turk Evlija Çelebi dhe analizimi i gravurës "Berati i vitit 1813").

NGA DRITAN ÇOKU

Pak historik mbi sahat kullat

Qytetet shqiptare në përgjithësi janë të paji sura me kulla të larta me sahate e çanaqe, e cila është një veçori, diçka e rrallë për qendrat e tjera turke ("cosa insolita in Turchia"). Në mungesë të sahateve personale (të xhepit dhe të murit), objekte këto të rralla dhe shumë të shtrenjta, popullsia qytetare, sidomos shtresa zejtaro-tregëtare e pasur, sunduesit feudal, etj., duke e ndjerë gjithnjë e më shumë nevojën për matjen e kohës, nën shembullin e qyteteve dalmatine italiane, me të cilat kishte kontakte më të shpeshta, ndërtoi me shpenëzimet e veta sahatet publike. Ndërtimi i këtyre objekteve të rëndësishme urbanistike shënonte, pa dyshim, një kërkesë të ngritur të shoqërisë qytetare të kohës në vendin tonë. (Zija Shkodra, Esnafët Shqiptarë (shek.XV-XX), Tiranë, 1973, f.44)

Si organizata zejtaro-tregëtare me funksione të rëndësishme social-ekonomike në kuadrin e shoqërisë feudale-qytatare, si institucione të rëndësishme të njohura dhe të përkrahura nga aparati qeveritar qendror dhe krahinor, esnafët mund të konsiderohen me të drejtë si persona juridikë të kohës. Kjo konsideratë gjen mbështetje në faktin se këto organizma shoqërore kishin rregullat e tyre, fondet e pavarura monetare, pasuritë e tundëshme dhe të patundëshme, nga të cilat kishin të ardhura dhe prej të cilave bën shpenzime, pasi kishin vulën, flamurin, etj. (Po aty, f.162) Esnafët shpenzonin fonde të konsiderueshme për ndreqjen dhe mirëmbajtjen e çesmave publike, rrugëve, kanaleve apo veprave të artit: urave, shatërvanëve, kullave të sahateve, xhamive, kishave, etj. (Po aty, f.170) Në pjesën më të madhe sahatet publike u vendosën në qendër të pazareve. Pirgje të larta prej guri të pajisura me sahate të bukura, që ishin shpikje e rëndësishme e kohës, u ndërtuan pothuajse në të gjithë qendrat kryesore të vendit, si në Prizren, Prishtinë, Pejë, Shkup, Shkodër, Elbasan, Berat, etj. Më vonë këto mjete, të nevojshme për shoqërinë qytetare, duken edhe në Tiranë, Krujë, Kavajë, Korçë, etj. Në kujtimet e udhëtarëve të ndryshëm gjejmë përshkrime të hollësishme të këtyre objekteve të shërbimit publik. Më i vjetri nga këto, ndofta edhe më i pari në Turqi, ishte sahati i Shkupit (fig.1,2). Sipas shënimeve të një udhëtari freng (1574), otomanët e sollën këtë nga Sigeta (Hungaria) bashkë me një teknik, të cilin e paguanin mirë. Mendohet se sahati i Shkupit u vu në veprim aty rreth viteve 1566-1574. (Po aty, f.45) Për këtë flet edhe udhëtari arab Haxhi Kallfa, i cili thotë se "shënon kohën natë e ditë dhe tingulli i tij dëgjohet dy orë rreth e përqark"(Po aty, f.46). Udhëpërshkruesi turk Evlija Çelebiu e përmend Kullën e Sahatit në Shkup si një ndërtim monumental e lartë sa një minare, afër



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8




Fig. 9



Fig. 10



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 11



Fig. 14



Fig. 15

xhamisë Hyngjarit, me një këmbanë që dëgjohet deri një ditë larg. (Muhamet Dhil-li Ibni Dervishi (Evlija Çelebi), Shqipëria para tre shekujsh, Enciklopedi shqiptare e mesjetës, botim i plotë, Besa 2000, Tiranë, 2000, f.130) Siç dihet, kjo gjini arkitektonike e lidhur ngushtë me shpikjen e mekanizmit të orës është shfaqur në Europë në shek.XIV. Tregëtarët shqiptarë të cilët kishin kontakte të shpeshta me qytetet Europiane, sollën që andej mekanizmat e orës dhe ndërtuesit vendas materializuan këtë sukses të mendimit njerëzor në vendin e tyre, duke krijuar kullat e sahatit si objekte për përdorim kolektiv për kohëmatje. (Sulejman Dashi, Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë Monumentet 12,1976, Mihal Duri, Tiranë, 1976, f.101) Sipas pohimeve të udhëtarit venedikas të vitit 1570, Berati ishte një qytet mjaft i madh ("assai grande"), i rrethuar me mure të larta, nën të cilat ndodheshin një ose disa lagje të bukura, ku prodhoheshin e tregëtoheshin "mallra të çdo lloji". (Zija Shkodra, Esnafët Shqiptarë (shek.XV-XX), Tiranë, 1973, f.32) Karakteristikën kryesore të strukturës urbanistike të qytetit duke filluar që prej shek.XVII e përbën lindja dhe zhvillimi i formacionit islamiko-oriental si komponent i rëndësishëm i ansamblit urban të kësaj kohe.(Ferit Duka, Berati në kohën osmane (shek.XVI-XVIII),Toena,Tiranë, 2001, f.173)

Në këtë shkrim ne do të ofrojmë jo vetëm nga ana historike, por edhe asaj ilustrative mbi "Ndërtesat e mrekullueshme të Beratit" - është një nënëtitull që në realitet duhet të përcaktohet (mbi veprat e çuditshme dhe të papara të ndërtimit). Këtu flitet mbi Kullën e Sahatit. (Vasfi Samimi, Berati 300 vjet më parë, Një studim mbi Evlia Çelebiun mbi qytetin dhe kështjellën e Beratit, Dita 2000, Tiranë, 2007, f.67)

Ja si e përshkruan udhëtari turk Evlija Çelebiu në vitin 1670 kur ai vizitoi Beratin:"Brenda në pazar gjendet një vepër e çuditshme, e paparë - kjo është kulla e sahatit, e lartë me krye drejtuar nga qielli, e pajisur me një kambanë të madhe të ardhur nga Ardeli. Ka një kambanë brenda së cilës mund të hynë 10 veta. Në kohën e drekës bie 10 herë. Zëri i saj dëgjohet prej një largësie deri në një ditë rrugë. Kjo nuk mund të përshkruhet aq, dhe as që mund të kallzohet, por është e domosdoshme që të shikohet në vend, sepse është një sahat me të vërtetë i çuditshëm". (Po aty, f.36) Kjo vepër monumentale sëbashku me ndërtime të tjera krijonin peisazhin urbanistik të qytetit të Beratit në atë kohë. Vendodhja e saj dëshmohet në qendër të tregut, në skicë-planimetrinë e fillim shek.XX dhe saktësisht të vitit 1912 (fig.3).

Për kullat e Sahatit në qytetin e Beratit shkruan Eqrem bej Vlora në botimin "Ditar (Nga Berati në Tomorr dhe kthim)". Ai na ofron disa të dhëna për lagjen Murad Çelebi, sipas tij "kjo lagje nuk ka histori të hershme. Këtu nuk gjen kujtime të së shkuarës përveç një kulle katërkëndëshe, ndërtuar me gurë gëlqerorë të pagdhendur, të lartë thuaj 30 metra (fig.5) dhe që duhet të ketë qenë një kullë vrojtimi e kohës së hershme turke. Tani sikundër edhe një tjetër e ngjashme në qytet (fig.4), mbart paqësisht një orë". (Eqrem bej Vlora, Ditar (Nga Berati në Tomorr dhe kthim), "KOÇI", Tiranë, 2003, f.52)

Të së njëjtit mendimi për Kullën e Sahatit në qendër të lagjes Murat Çelebi, e cila mund të ketë qenë së pari kullë vrojtimi shkruhet edhe në botimin "Berati historia dhe arkitektura" të A.Baçe, A.Meksi, E.Riza. (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza,

Berati historia dhe arkitektura, "8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.95)

Me këtë llojë arsyetimi nga të dy burimet e shkruara ne nuk ndajmë të njëjtin mendim. Kalaja e Beratit, zotëron një pozitë gjeografike e strategjike mjaft të rëndësishme, gjë që e bën atë të dallojë nga qendrat e tjera përreth. Ky fakt të jep arsyen se vrojtimi mund të bëhej fare mirë nga trualli i kalasë. Kjo pozitë e lejonte atë të mbronte dhe të kontrollonte kalimin përgjatë luginës së Osumit në rrjedhën e tij të mesme, nëpërmjet rrugëve kryesore dhe atyre të dorës së dytë që e lidhin me Ultësirën Bregdetare dhe me zonat e brendshme të vendit. Nga pikpamja e pozitës fizikogjeografike Berati dhe rrethinat e tij bën pjesë në zonën kodrinore më të madhe të vendit tonë, që shtrihet midis lumenjve Vjosë dhe Osum-Semanit. (Hëna Spahiu, Qyteti iliro-arbëror i Beratit, Mihal Duri, Tiranë, 1990, f.11) Pra, saktësojmë arsyetimin se, në lagjen Murat Çelebi, kulla nuk mund të ketë qenë kullë vrojtimi, por Kullë Sahati dhe ka ekzituar që në fillim si e tillë. Sipas fotove fakte të dy kullat e sahatit në qytetin e Beratit kanë të njëjtin ndërtim arkitektonik, por jo atë autentik original. Kulla midis dy xhamive në gravurë (fig.7 F) mund të jetë Kulla e Sahatit në lagjen Murat Çelebi e cila është shkatërruar si pasojë e tërmetit të 15 Tetorit 1851 dhe pas kësaj kohe një tjetër Kullë Sahati është ndërtuar po në të njëjtin vend në këtë lagje dhe në të njëjtën kohë kur u ndërtua kulla e dytë e Sahatit në pazarin (çarshinë) e qytetit, me kontributin e tregëtarëve beratas, nga ndërtues vendas në gjysmën e dytë të shek.XIX si një domosdoshmëri e këtij objekti për përdorim kolektiv për kohëmatje.

Kulla e Sahatit në lagjen "Murat Çelebi" u prish në vitin 1967. Planimetria e saj ishte katrore 4m x 4m, si dhe lartësia 17.5m. Në kullë hyhej në një portë me qemer nëpërmjet shkallëve të gurta. Në brëndësi të saj kishte shkallë të drunjta për të hipur lart tek menkanizmi i orës. Kulla merrte dritë nga disa dritare të vogla tip fërngji në të katër anët e saj. Ajo ishte e ndërtuar prej mur guri, më pas merrte formën trapezoidale e mbuluar me tjegulla deri në kontruksionin e katër kollonave të ambjentit të këmbanës, e cila mbulohej me çati druri dhe fletë plumbi. Duke folur mbi ndërtimet me karakter publik në Beratin e shek.XVI-XVII, Prof. Dr. Ferit Duka në monografinë e tij "Berati në kohën osmane (shek.XVI-XVIII)" specifikon si monumente interesante që shquajnë në arkitekturën e qytetit të Beratit gjatë kohës për të cilën ai flet, edhe dy kullat e sahatit: njera në pazarin (çarshinë) e qytetit, ndërsa tjetra në mëhallën Murat Çelebi. (Ferit Duka, Berati në kohën osmane (shek.XVI-XVIII),Toena,Tiranë, 2001, f.216)

Berati është vizituar nga mjaft piktorë të huaj duke u bërë edhe pjesë e krijimtarisë së tyre. Elementët real të pesiazhit të Beratit, i gjejmë te ikona dhe afreske të pikturës bizantine e posbizantine, por dhe te udhëtimet e artistëve europianë. Po çfarë dokumentash ilustrative trashëgojmë ne sot se si ka qenë e ndërtuar Kulla e Sahatit në pazarin (çarshinë) e qytetit, me pamjen e saj autentike arkitektonike.

Dokumentimi ilustrativ më i vjetër që disponojmë është një gravurë e vitit 1813 (fig.6) e realizuar nga anglezi Charls Cockerell, i cili ishte arkitekt, arkeolog dhe shkrimtar. Përsa i përket gravurës, anglezi Charls Cockerell, mendojmë se ka bërë një trajtim të qëllimshëm duke dhënë në një kuadër të vetëm pjesët më të bukura dhe karakteristike si: Urën e Goricës (A), lagjen "Mangalem", kishën e shën Mëhillit dhe pamjen jug-perëndimore të kalasë, por edhe objektet më të rëndësishme të qëndrës së qytetit: Xhaminë e Plumbit (B) dhe Kullën e Sahatit (C). (Genci Samimi, Dritan Çoku, Datimi i banesës Llavda sot muzeu Etnografik, Berat, 2008, f.31) Xhamia tjetër me kupolë (D) e ndodhur nga e djathta e gravurës, mendojmë se mund të jetë xhamia e Hysejn Pashajt në lagjen "Murat Çelebi", pasi gjejmë një përputhje të përshkrimit të E.Çelebiut dhe arkitekturës në gravurë, vizualisht. Sipas orientalistit V.Buharaja, nga ndërtimi i vjetër i kësaj xhamie që trashëgojmë sot është vetëm minarja. Në krahë të xhamisë shohim një ndërtim rrethor i cili mbulohet nga një kupolë (E), që mund të jetë një tyrbe (varr monumental kushtuar një kleriku bektashian. Zakonisht kanë një çati me kupolë poligonale). Megjithatë mbi analizimin e gravurës do të flas shkurtimisht në këtë shkrim.



Fig. 16


Fig. 17

Fotografitë më të vjetra të Kullës së Sahatit në pazarin e Bulmetit janë ato të misionit hollandez 1913-1914, (fig.4,8) që disponojmë ne sot. Por ne do të japim dhe fotografi të vjetra të datura të kësaj trashëgimie arkitektonike, që na çojnë deri në vitin 1916 (fig.9).

Përveç tyre, disponojmë dhe një foto të sheshit të pazarit të bulmetit


Fig. 18


Fig. 19

me ndërtimet përreth saj, por që kulla e Sahatit nuk ekziston. Fotoja daton e vitit 1927 (fig.10). Në muajt mars-prill të vitit 1916, në rrjedhën e Vjosës, ishte shtrirë fronti i luftimeve midis italianëve dhe austro-hungarezëve. Më pas Berati ra nën okupimin austro-hungarez, deri në tetor të vitit 1918. (Marela Guga, Prefektura e Beratit 1920-1939, Albanian University Press, Tiranë, 2012, f.18) Gjatë pushtimit austro-hungarez, mjaft dyqane dhe ndërtesa u shkatërruan. (Po aty, f.19)

Këtë fat, mund të ketë patur edhe Kulla e Sahatit, një prej ndërtimeve që u shkatërruan atë kohë në qendër të qytetit. Për mendimin tonë, në vendin ku ndodhej ky ndërtim i shërbimit publik, ka ekzistuar një më e vjetër më përpara, atë që na informon E.Çelebiu. Për fatin e saj nuk kemi mësuar gjë. Mirëpo, nga hulumtimet e deritanishme dhe për çudinë tonë të madhe, si nga letërsia historiografike ashtu edhe prej burimeve të shkruara të gjysmës së parë të shek.XIX, në përshkrimin nga udhëtarë të huaj që i bëjnë qytetit të Beratit nuk përmëndet prania e ndonjë Kulle Sahati, ndonëse japin një përshkrim elegant dhe piktoresk ku veçohen vlerat arkitekturore dhe bukuritë e qytetit, madje në disa


Fig. 20


Fig. 21


Fig. 22

raste deri në detaje mjaft interesante. Të jetë kjo një anashkalim i këtyre udhëtarëve pa përmëndur kullat e sahatit, sidomos atë në çarshinë e qytetit që përshkruan Çelebiu, duke mos parë ndonjë veçori, apo ka qenë e rrënuar në atë kohë për ndonjë arsye që ne nuk e kemi mësuar akoma? Këtu mund të përmendim historianin anglez Smart Hughes në (maj 1814) në "Travels in Sicily, Greece & Albania", Vol.2, botim i vitit 1820; David Urquhart një diplomat dhe shkrimtar skocez në (nëntor 1831) në "The Spirit of the East", botuar në vitin 1838, piktorin dhe poetin britanik Edëard Lear (tetor 1848) në "Journal of a Landscape Painter in Albania", botuar në 1851 dhe Edmund Spencer shkrimtar britanik (1850) me botimin "Travels in european Turkey in 1850" Vol.2, botuar në 1851.

I njëjtë për nga tipologjia, në këtë rast bëjmë krahasimin me Kullat e Sahatit që u ndërtuan në gjysmën e dytë të shek.XIX në Berat (fig.21,22 punuar nga Dritan Çoku) edhe Kulla e Sahatit në Dibër të Maqedonisë (fig.11). Fotografia më e vjetër e saj është me autor fotografin austriak Josef Szekély, "Dibra", 21 Shtator 1863. Thuhet se ai ka bërë fotot më të hershme në Shqipëri. Kulla e Sahatit në Dibër, ishte ndërtuar në shpatin e butë në xhaminë Inkjar, e cila u shkatërrua pas Luftës së Dytë Botërore. (http://ëëë.islamskazaednica.com/forum/index.php?/topic/3807) Por, në Kosovë, kemi dy kulla sahati të datuara, të cilat futen në këtë tipologji arkitekturore: e para, në Rahovec 1206H/1791 (fig.12), e dyta në Mamusha 1230H/1814-15 (fig.13) është një komunë që shtrihet 15 km në veri të Prizrenit, rrugës për Rahovec. Të dyja këto kulla sahati janë ndërtuar nga Mahmud Pasha.

Mirëpo duke bërë krahasimin midis gravurës dhe fotove të vjetra, vërejmë se kulla e sahatit në pazarin (çarshinë) e qytetit nuk është i njëjti ndërtim.

Është e vërtetë që një obortar i sulltanit në atë kohë, Çelebiu, do të tregonte e përshkruante në shkallë hiperbolike mbi arritjet e perandorisë osmane në hapësirën e saj, por duke parë mjaft përshkrime që i bën qytetit të mrekullueshëm të Beratit dhe duke verifikuar disa prej tyre shohim një vërtetësi në përshkrim. Për mendimin tonë, Çelebiu, kur kalon në disa hollësira mbi madhësinë e këmbanës, lartësinë e kullës së sahatit etj., të gjitha këto kanë rëndësi për një studim arkeologjik e historik. Ai e cilëson që nuk mund të përshkruhet dhe të kallzohet, por duhet të shihet në vend, sepse është mjaft i çuditshëm. Por si mendojmë ne që mund të ketë qenë Kulla e Sahatit në pazarin (çarshinë) e qytetit duke e krahasuar përshkrimin mahnitës së E.Çelebiut dhe analizës dhe zbërthimit të gravurës së vitit 1813?

Analizimi i gravurës së vitit 1813

Fatkeqësisht në Shqipëri nuk ruhet asnjë ndërtim autentik origjinal i kullave të sahatit si në Elbasan ashtu edhe në Shkodër që kanë qenë të së njëjtës periudhe me atë të Beratit (shek.XVII). Duke parë deri në hollësira mbi ndërtimet e pasqyruara në gravurë, shohim dy ndërtime në mur guri me bazë katërkëndore dhe në përfundim të muraturës njëra prej kullave ka një hapësirë (dritare) me hark, ndërsa tjetra dy hapësira (dritare), që të dy ndërtimet arkitektonike mbyllen me mbulimin në formën prizmatike me bazë katërkëndore. Por, natyrshëm lind pyetja: A mos vallë janë kulla këmbanash kishe në qytetin e Beratit dhe autori ka realizuar ndonjë stilizim? Të vetmen pikëpyetje që kishim ishte kisha e shën Mërisë në lagjen Mangalem ku brenda oborrit të saj kishte një kullë këmbane (sot ky objekt kulti nuk ekziston). Këtë rast do të mundohemi t'jua vërtetojmë me fakte.

Në revistën mujore "Diturija" të Lumo Skëndos kemi një artikull me titull "Berati Plak" me 5 korrik 1927 nga z .Gjergj Haxhi Mihali. Ai na informon se "nën kishën e shën Mëhillit është kisha e shën Mërisë Shumbullit, përmbi udhën e madhe anës së lumit; ndofta ka qenë kishë e vogël dhe më përpara po, sipas gojdhënës së pleqve u bë transferim, pas okupacionit turk, i kishës së shën Mërisë së lagjes Murat Çelebi në këtë vend; në vitin 1800 u dogj, po u ngrit prapë si është dhe sot me piktura të bukura në vitin 1808." (Gjergj Haxhimihali," Berati plak", art. Në revistën Diturija, Vol.II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.335)

Duke hulumtuar më tej, gjejmë një foto-fakt, plan detaj i hyrjes së portës së oborrit nën këmbanoren e kishës së shën Mërisë në lagjen Mangalem (fig.14), mbishkrime dhe datimin e vitit 1856. Pra, ndërtimi i këmbanores është realizuar në vitin 1856 (fig.15) sipas datimit në portën e jashtme të oborrit. Mos ekzistencën e këmbanores ne e shohim edhe në një prej gravurave të piktorit Edëard Lear, i cili pikturoi peisazhin e Beratit në tetor të vitit 1848 (fig.16). Duke vrojtuar me kujdes dhe duke studiuar kishat e qytetit të Beratit, këto dy ndërtime të paraqitura në gravurë, nuk janë pjesë e objekteve të kultit të krishterë në Berat, në funksionin si kullë këmbanash.

Kulla e sahatit që ne mendojmë në gravurën "Berati 1813" duke e parë vizualisht është ndërtim i gjithë prej guri (shih C në gravurë), ku në katin e sipërm të kullës, pra tek këmbanorja muratura është e

→ Vijon në faqen 6

KULLAT e SAHATIT në BERAT

→ Vijon në faqen 28

NGA DRITAN ÇOKU

hapur me nga një hapësirë (dritare) me hark për seicilën faqe, ndërsa mbulesa është një piramidë me bazë katërkëndore. Pavarësisht se kjo gravurë është një punim artistik, duhet theksuar se autori i saj ka qenë mjaft i kujdesshëm dhe është munduar të jap në realitet mjaft detaje të sakta të arkitekturës në Berat, për vet profesionin e tij, si arkitekt

(specialist që merret me artin e dizenjimit dhe të ndërtimit të objekteve me karakter shoqëror, prodhues, banimi, sepulkral etj., si dhe vendosjes së tyre në hapësirë), dhe si arkeolog (specialist i cili merret me studimin e historisë së shkuar njerëzore nëpërmjet përdorimit të metodave e teorive arkeologjike, me qëllim dokumentimin, interpretimin dhe perceptimin e kulturave dhe mënyrave të jetesës të shoqërive të lashta). Është e rëndësishme të përmendim disa nga saktësitë e detajeve dhe ndërtimeve arkitektonike në qytetin e Beratit (shih gravurën fig.6,7), si: ndërtimin arkitektonik të urës së Goricës me kurrize dhe numrin e harqeve (ky është ndërtimi nën përkujdesjen e Ahmet Kurt pashës më 1777. Në shek.XVII ka qenë me nëntë harqe prej druri, ndërsa themelet e urës qëndronin mbi këmbë prej guri të çuditshëm të zhytur në ujë). (Vafsi Samimi, Berati 300 vjet më parë, Një studim mbi Evlia Çelebiun mbi qytetin dhe kështjellën e Beratit, Dita 2000, Tiranë, 2007, f.38) Ndërtimin arkitektonik të xhamisë së Plumbit, (në shek.XVII haremi i jashtëm, këtu Çelebiu e ka fjalën për hajatin, rreth e rrotull sofa, ku gjenden kolona të bardha mermeri të shkëlqyshme. Kreu i këtyre është mbuluar me 7 kube të mëdha, mbuluar me plumb (Po aty, f.33), sot hajati i mbyllur). Ndërtimin e banesave dy katëshe prej guri, elemente të konsolit të zbuluar dhe mbështetja me testek, dritare me hapësira drite mjaft të vogla, karakteristike e ndërtimeve të banimit të asaj kohe, çardaku, një element kryesor në tipologjinë e banesës beratase, ballkoni, tymare mbi çati, element i thjeshtë në dukje, por që merr pjesë në formulimin arkitektonik të monumentit dhe i jep natyrshëm një plotësim dhe vlerësim. Fashatura në ballin e strehës të punuara nga ana dekorative, detaje porte dyflegërshe, detaje dritaresh prej kangjellash dhe kapakë druri, detaji i shkallëve, pikturimi me ornamente floreale i suvatimeve në banesat e ndërtuara rishtazi në atë kohë, ose ato që pësonin rikonstruksione ku vendosej edhe datimi i rikonstruksionit etj.

Në Hercegovinë, në qytetin Mostar, Kulla e Sahatit (fig.17) është ndërtuar para vitit 1636, në qytetin Poticejl, ndërtim para 1664 (fig.18), po në të njëjtën kohë me dy të parat është ndërtuar dhe kulla e sahatit në Stolac (fig.19) e cila u shkatërrua në vitin 1930 dhe u rindërtua në vitin 2012 me po ato karakteristika historike dhe stilistike. I ofruam këto shembuj për të dhënë një informacion mbi karakeristikat e ndërtimeve të kullave të sahatit në shek.XVII, ngjashmëritë e tyre nga ana stilistike dhe si tipologji arkitekturore. Në rastin e kësaj tipologjie arkitekturore ne ndoqëm proçesin e argumentimit përmes të cilit dy fenomene ose objekte kanë disa ngjashmëri. Kulla e Sahatit, e paraqitur në gravurë (C), sipas mendimit tonë është ndërtimi autentik original (fig.20, punuar nga Dritan Çoku), është ajo kullë që ka parë Çelebiu. Ajo ka ngjashmëri me kullat e sipërpërmendura në qytetet e Hercegovinës, gjithnjë në rrafshin e tipologjisë arkitekturore dhe kohore.

Së fundi, mendojmë të realizojmë një botim të veçantë me temë "Kullat mesjetare të Sahatit në Shqipëri dhe trevat shqipfolëse", i cili do të pasuronte informacionin mbi këtë trashëgimi arkitektonike, të paraqesë një katalogim të hollësishëm, të studiuara, të klasifikuara sipas kronologjisë dhe studimit tipologjik, madje, do të evidentonte përmasat e vetë arkitekturës së mesjetës së vonë dhe jetës qytetare me vlerat historike e kulturore të saj.

REVIEW

Botohet, shtatëdhjetë vjet pasi ishte përgatitur (1942), koleksioni "Tokat shqiptare të lirueme" - "Le terre albanesi redente: II, Ciameria", pjesë e kolanës "Albanistica", që drejtohet nga prof. Francesco Altimari, realizuar me kujdesin përgatitor dhe me një studim hyrës analitik nga Donato Martucci.

"PER PAS LUFTE" -

NGA PROF. SHABAN SINANI

Viti 2012, viti i qindvjetëshit të shtetit shqiptar, solli në jetë një re vistë të re shkencore të mirëseardhur dhe një kolanë të re botimesh: revistën "Res Albanicae" dhe kolanën "Albanistica", që drejtohet nga prof. Francesco Altimari dhe është pronë intelektuale e Fondacionit Universitar "Francesco Solano".

"Le terre albanesi redente: II. Ciameria" - "Tokat shqiptare të liruara: II. Ciameria", është vëllimi i dytë i kësaj kolane dhe sapo ka dalë në qarkullim. Ky vëllim ka një histori të ndërlikuar, të cilën e ka shpjeguar gjerësisht në hyrjen analitike përkujdesësi i tij Donato Martucci, titulluar: "A dopo la guerra": Un libro "inopportuno" tra irredentismo albanese e propaganda fascista" - "Për pas luftës": Një libër i papërshtatshëm në mes irredentizmit shqiptar dhe propagandës fashiste". Pjesën e parë të titullit, "A dopo la guerra" - "Pasi të mbarojë lufta", përgatitësi e ka marrë nga një shenjim urdhërues me shkrim dore, që gjendet në dosjen ku janë koleksionuar studimet. Ndërsa pjesa e dytë e titullit është një shpjegim pse botimi u shty për një periudhë "pas luftë": autoritetet fashiste, pasi kaloi faza e parë e pushtimit në Greqi, nuk donin ta përdornin më irredentizmin shqiptar për ndërlikimin e situatës në rajon: lufta italo-greke ishte shpallur, preteksti ishte gjetur, shqiptarët ishin përdorur tashmë në provokimin e konfliktit, ëndrra shqiptare për një Shqipëri historike dhe ideologjia fashiste për ekspansion e kishin realizuar qëllimin.

Siç e shpjegon dhe e dëshmon me burime arkivistike përkujdesësi D. Martucci, iniciativa për një kërkim shkencor italo-shqiptar paradigmatik për ato që quheshin "toka të lirueme": Kosova dhe Çamëria (histori, etnologji, arkeologji, folkloristikë, gjeologji, floristikë), ka qenë një propozim i "Presidenza del Centro Studi per l'Albania" - i kryesisë së Qendrës së Studimeve për Shqipërinë, që mban titullin "Piano di pubblicazioni sulla Ciamuria e sull Cossovo", dhe datën 10 maj 1941.

Ekspertiza që i ka bërë D. Martucci historisë së përgatitjes dhe fatit të mëvonshëm të këtyre studimeve është shumë e qartë dhe kompetente. Nga ky botim mësohet për herë të parë se vëllimi me studime për Kosovën, vëllimi i parë, ishte botuar qysh në vitin 1942, kurse vëllimi i dytë, që kemi sot në duar, prej më shumë se 70 vjetësh gjendej në ruajtje në bozze në Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei, Fondo Accademia d'Italia, Centro Studi per l'Albania, për arsyen që u përmend.

Sikurse dihet, në qeverinë shqiptare të periudhës fashiste kishte dhe një ministri për "tokat e lirueme" ("ministero per i territori liberi"), që e drejtonte Ekrem bej Vlora. Kjo ministri, Instituti i Studimeve Shqiptare, Ministria e Kulturës Popullore, kishin për detyrë jo vetëm të përhapnin arsimin shqip në Kosovë, në viset shqiptare në Maqedoni e Çamëri, po dhe të inkurajonin studimet albanistike në këto territore, duke përfituar prej mundësive të krijuara për një veprim përtej kufijve të "Shqipërisë së vjetër" nga ajo që u quajt "Grande Albania", "Shqipëri e madhe".

Në tërësinë e vet koleksioni i studimeve të përgatitura prej bashkëpunëtorëve shqiptarë, italo-shqiptarë e italianë të Centro Studi d'Albania, ka një kopje tërësore që ruhet në AQSH ("Studi preparati per l'Accademia Reale d'Italia"). Këto studime të bëjnë shumë përshtypje edhe për faktin që vërehet me lehtësi, se e kishin kaluar fazën e parë të shtypshkrimit, ishin të lidhur në fashikuj si separatet që u dhurohen sot autorëve. Duke u njohur me përmbajtjen e tyre mund të krijosh bindjen se pikërisht hija e "Shqipërisë





G. Petrotta

së madhe" dhe e irredentizmit shqiptar duhej të kishte qenë shkak pse ato studime kishin mbetur në gjendje bllokimi. Disa prova që u bënë dhjetë vjet më parë (2003-2003) me qendra universitare dhe kërkimore brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë universitete dhe qendra shkencore italiane, dështuan, duke provuar se kjo hije ekzistonte ende. Prandaj është kënaqësi të vëresh tejkalimin e këtyre pengesave. Për këtë përgëzimet i takojnë drejtuesit të kolanës prof. F. Altimarit; përkujdesësit e përgatitësit të vëllimit Donato Martucci, që ia arritën t'i japin lexuesit studime që gjendeshin jashtë bibliografive shqiptare dhe për më tepër edhe sot kanë rëndësi shkencore dhe informuese.

Titulli që i ka vënë D. Martucci hyrjes së tij e shpreh në mënyrë sintetike arsyen pse kaq vonë u ringjallën e dolën nga arkivat këto studime. Ka të ngjarë që disa studime të tjera të kenë mbetur në AQSH dhe burimet që janë zgjedhur e botuar prej Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei, Fondo Accademia d'Italia, Centro Studi per l'Albania të plotësohen me tituj të tjerë. Dihet mirë se E. Çabej, në një letër tashmë të botuar, asokohe ishte i ngarkuar të plotësonte pjesën e gjuhës shqipe në atlasin e gjuhëve indoeuropiane, dhe për këtë arsye refuzoi me elegancë edhe detyrën e ministrit të arsimit, duke shkruar se "nëse vërtet mendoni për të mirën time, më shtoni sadopak bursën për të vazhduar punën me atlasin". Por nuk përjashtohet të ketë pasur dhe kontribute vullnetare për botimin, veç atyre të parapaguara nga Accademia Reale d'Italia, të paktën duke iu referuar koleksionit që ruhet në AQSH, që duhet të ketë mbi 30 tituj (duke përfshirë studimet e vëllimit të parë dhe të dytë së bashku).

Vetë ky vëllim ofron dëshmi se interesi italian për etnosin shqiptar në viset që kishin mbetur jashtë kufijve të saj të vendosur më 1913 në Londër kishte nisur më herët dhe nuk mbetej brenda studimeve të porositura. Do të ishte me shumë interes të dihej, për shembull, çfarë përmban relacioni diplomatik i Oreste Graziani-t, secondo segretario në ambasadën italiane në Athinë, titulluar "Pakicat shqiptare në Greqi" ["Le minoranze albanesi in Grecia"], apo trajtesa e Dhimitër Beratit me titull "Epiri e Shqipëria" ["L'Epiro e l'Albania"], shkruar më 1943.

Vëllimi hapet me studimin e Gaetano Petrotta-s, studiues i njohur italo-shqiptar, "Resistenza e conservazione della lingua albanese nell'Epiro e propulsione letteraria della Ciamuria" - "Rezistenca dhe vetëruajtja e gjuhës shqipe në Epir dhe rrjedhat letrare në Çamëri". Është një studim me karakter multi-